



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI BASHKISË

V E N D I M

Nr. 65 datë 02.10 2024

PËR

“MIRATIMIN E PROCEDURAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT SOCIAL TË
STREHIMIT “SUBVENCIONI I KREDISË 2025 ”

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutë, nenit 8 pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjin nr. 48/2023 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 22/2018, Për Strehimin Social”, vendimit nr. 361 datë 29.05.2019 “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre i strehimit, në rastet e parashikuara në ligj dhe bashkëpunimit institucional”, vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutur strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM Nr 268 datë 29.04.2022, për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr 453, datë 03.07.2019, të Këshillit të Ministrave për “ Masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesa me kosto të ulët, me kredi të lehtësuara nga Buxheti i Shtetit/Njësia e Qeverisjes Vendore”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e datës 02.10 2024

V E N D O S I:

1. Miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencioni i kredisë”, hartuar sipas udhëzuesit operacional bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Ngarkohen Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Shëndetësore, Drejtoria e Financës, Njësitë Administrative dhe Komisioni i Strehimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

Merita ISARAJ

